



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPSTINA LIPLJAN
MINICIPALITY OF LIPJAN

SHMP "ADEM GLLAVICA" LIPJAN

Shkolla e Mesme Profesionale "Adem Gllavica" në Lipjan është institucion edukativ arsimor që edukon, arsimon dhe aftëson rininë dhe të rriturit me arsimim të mesëm profesional. Ajo gjatë veprimtarisë të vetë arsimore do të përgatis kadro të profileve të ndryshme në bazë të kërkesave zhvillimore shoqërore dhe tregut të lirë të punës. Karakteristikat (Etosi) që e dallon këtë shkollë profesionale nga shkollat tjera në R. e Kosovës janë:

Fillet e para të arsimit të mesëm në Komunën e Lipjanit datojnë nga viti 1961, atëherë kur Kuvendi Popullor i Lipjanit në pajtim me SK të Arsimit dhe Kulturës, mori vendim të veçantë për themelimin e Shkollës së ultë dyvjeçare Bujqësore të drejtimit lavërtar-traktorist.

Në vitin shkollor 1963/64 Shkolla e ultë bujqësore u shndërrua në Shkollë të Mesme bujqësore. Objekti shkollor ku është zhvilluar procesi i mësimdhënies ka qenë shtëpia e tashme e kulturës. Mësimi në këtë shkollë është zhvilluar vetëm në gjuhën serbokroate. Për nxënësit e regjistruar shqiptarë, vetëm mësimi i lëndës së Gjuhës shqipe është ligjësuar në gjuhën amtare

Në vitin 1970 formohet Shkolla e Mesme Teknike me drejtimin e makinerisë. Pas reformave të bëra në arsim dhe aprovimit të "Ligjit mbi arsimin dhe edukimin e Mesëm të orientuar" në vitin 1976, u bë fuzionimi i dy shkollave të mesme të atëhershme të Lipjanit dhe si rezultat i këtij fuzionimi u themelua Qendra e Arsimit të Mesëm. Sipas kësaj reforme, nxënësit në dy vitet e para ndiqnin mësimin e lëndëve të përbashkëta (faza e pare), ndërsa në klasën e tretë orientoheshin në drejtime dhe profesione të ndryshme të miratuara nga Sekretariati Krahinor i Arsimit dhe kulturës së Kosovës.

Në vitin 1990 gjegjësisht në qershor të këtij viti bëhet revidimi i Rrjetit shkollor të Kosovës. Si rezultat i këtij rrjeti themelohet Shkolla e Mesme e cila në vitin 1992 u emërua me emrin "Ulpiana". Me këtë emër shkolla ka vepruar gjer në vitin shkollor 2002/03. Në qershor të vitit 2003 MASHT, për hirë të organizimit më të mirë të punës dhe kërkesës së drejtorisë të shkollës mori vendim për ndarjen e saj në dy shkolla. Kështu u formua Shkolla e Mesme profesionale dhe Gjimnazi. Shkolla e Mesme Profesionale e fillon aktivitetin e vetë arsimor-edukativ nga viti shkollor 2003/2004. Në 27 Nëntor të vitit 2003 SHMP e mori emrin e patriotit dhe luftëtarit shqiptar Adem Gllavica, ndërsa drejtor i parë i saj u zgjodh profesori Hajrush Stublla. Në vitin e themelimit shkolla i kishte 37 paralele me 1152 nxënës. Shkolla ka Ekonominë shkollë me 31 hektarë tokë punuese. Për organizimin e veprimtarisë arsimore shfrytëzon në lokal afër 5000 metra katror. Mësimin në SHMP e organizojnë 76 mësimdhënës 8 punëtorë ndihmës teknik, drejtori, sekretari, psikologu-ia dhe referenti.

Ne kuadër të shkollës organizohet mësimi për të rritur, gjithashtu nga viti shkollor 2015/16 ne kuadër të shkollës tonë funksionon shkolla edhe ne Qendrën Korrektuese në Lipjan ku janë të angazhuar 6 mësimdhënës.

Ne vitin 2019/2020 shkolla ka fituar një ndihme për renovimin e objektit të shkollës nga Ambasada Amerikane në vlerë prej 1.00000\$, gjë e cila ka krijuar kushte të përshtatshme për mbajtjen e procesit mësimor.

Ne vitin shkollor 2020/21 shkolla ka gjithsejtë 43 paralele dhe numëron 993 nxënës, në procesin mësimor janë të përfshirë 76 mësimdhënës të shpërndarë në 7 drejtime dhe 17 profile.

Në: Lipjan
Më: 18.08.2021

Drejtori i shkollës
Skender Rudari